



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

M Nr. / Br 36/21

Nr. i Sq. / Pr. si -1-

Data: / Datum 25.02.2021

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” lidhur me nenin 14, paragrafi 1 dhe 17 shkronja “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 41, paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/ L-159, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 shkurt 2021** merr këtë:

**VENDIM
PËR LEJIMIN E PAGESË S SË MJETEVE FINANCIARE PËR KEDS**

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën njëzetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katër dhjetë cent (24,992.40 €) për KEDS për marrjen e Pëlqimit për kyçjen në rrjetin elektroenergetik të Parkut Industrial në Lumadh.
2. Shuma e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të realizohet nga kategoria Komunali, nga Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë ditë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br 37/21

Nr. i fq. / Pr. sh -1-

Data / Datum 25.02.2021

VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41 paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 shkurt 2021**, merr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
"PËRPARIMI" SH.A NË VUSHTRRI

1. Me këtë Vendim caktohet lokacioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" Sh.A, në objektin e ish TMK-së në Vushtrri, që gjendet në pjesën e parcelës kadastrale P- 2358-12, në sipërfaqe prej 1550m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 41655m², Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komuna e Vushtrrisë, e cila parcelë është brenda zonës Urbane të Komunës së Vushtrrisë e paraparë si zonë ndërtimore.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr. 235/20 i datës 26.11.2020.
5. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUČITRA

01 Nr. / Nr. 38/21

Nr. i Eq. / Nr. sh -1-

Data: / Datum 25. 02. 2021

VUŠTRRI - VUČITRA



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" në lidhje me nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **25 shkurt 2021** merr këtë:

VENDIM PËR APROVIM TË KËRKESËS

1. Me këtë vendim aprohet kërkesa e parashtruar në emër të Suada Plakollit, për adoptimin e banesës së përbashkët e cila gjendet në rrugën "Dëshmorët e Kombit" Nr. 92 në Vushtri.
2. I delegohen kompetencat dhe përgjegjësitë Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, që të ndërmarrë të gjitha veprimet në zhvillimin e procedurave për intervenim në rregullimin e pullazit të asaj ndërtese.
3. Autorizohet qeveria komunale, që të ndërmarrë veprimet e nevojshme, duke përdorur mekanizmat ligjor të kontratave kornizë që i ka në dispozicion, për rinovimin e kësaj ndërtese, duke sanuar gjendjen e rënd në këtë objekt.
4. Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti, merren në kategorinë mallra dhe shërbime nga pozicioni Menaxhimi i Katastrofave Natyrore, kodi ekonomik 18468 në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

